

BULETIN



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Maj 2004

Buletin mujor Nr.5

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID “CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT”

PASQYRA E PËRMBAJTJES

1. **VEPRIMTARI VËZHGUESE TË KSHH-SË**
 - 1.1 Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të shtetasve në sistemin gjyqësor
 - 1.2 Mision vëzhgimi dhe verifikimi në burgun e Rrogozhinës
 - 1.3 Mision vëzhgimi në pikën kufitare të Kapshticës
 - 1.4 Misione mbështetëse të korrespondentëve lokalë të KSHH-së
2. **VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE**
 - 2.1 Emisione në televizione lokale
 - 2.2 Edukim i publikut nëpërmjet librit
3. **RAPORTE MBI RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT**
4. **VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE NË DREJTIM TË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË MINORITEVE**
5. **TRYEZAT DHE KONFERENCAT**
 - 5.1 Tryeza e rrumbullakët “Shërbimi ligjor falas dhe ai i caktuar kryesisht. Çfarë mund të përmirësojmë?”
6. **REAGIME PUBLIKE TË KSHH-së NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË DREJTAVE TË NJERIUT**
7. **SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-së**
8. **KSHH DHE MEDIA**
9. **KSHH DHE BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATATAT VENDASE DHE ATO TË HUAJA**
10. **PJESËMARRJA E KSHH-së NË VEPRIMTARI TË NDRYSHME**
11. **ANEKS – DEKLARATAT E KSHH-SË, MAJ 2004**

Rr: “Gjin Bue Shpata”, Pall. 5/1; Ap.4, Tiranë, Kutia postare Nr. 1752, Tel: 04 233671; 04229002
Fax: 04 233671; CEL: 068 20 23699; E-mail: office@ahc.org.al; Web-site: www.ahc.org.al

1. VEPRIMTARI VËZHGOESE TË KSHH-SË

1.1 Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të shtetasve në sistemin gjyqësor

Për të parë nga afër respektimin e të drejtave të shtetasve në sistemin gjyqësor shqiptar, gjatë periudhës prill-maj, korrespondentët e KSHH-së kryen vëzhgime pranë gjykatave të rretheve ku ata veprojnë.

Mënyra e funksionimit të gjykatave, respektimi i parimit të publicitetit të proceseve gjyqësore, solemniteti gjatë gjykimeve, respektimi i rregullave procedurale dhe atyre administrative, respektimi i afateve të zhvillimit të proceseve gjyqësore, vonesat në gjykime, etj, ishin disa nga problemet e vëzhguara. Gjithashtu objekt i vëzhgimeve ishte aksesimi i publikut dhe i gazetarëve në gjykata, pritja e popullit, mënyra e funksionimit të administratës së gjykatës, etj.,

Përfundimet e dala nga vëzhgimet dhe rekomandimet e KSHH-së për përmirësimin e situatës janë përmbledhur në një raport të veçantë të cilin do ta gjeni në faqen tonë të internetit në gjuhën shqipe dhe angleze.²

1.2 Mision vëzhgimi dhe verifikimi në burgun e Rrogozhinës

Bazuar në letrat dhe telefonatat e ardhura në adresë të KSHH-së nga të dënuarit që vuajnë dënimin në burgun e Rrogozhinës, në **19 maj 2004** KSHH ndërmori një mision vëzhgimi në këto ambiente me qëllim verifikimin dhe sqarimin e tyre. Për rastet e shkeljeve të konstatuara, KSHH-ja iu drejtua organeve kompetente.

1.3 Mision vëzhgimi në pikën kufitare të Kapshticës

Në kuadër të bashkëpunimit më grupin e Helsinkit Monitor dhe Komitetit Norvegjez të Helsinkit, bazuar në letrat dhe shqetësimet e emigrantëve shqiptarë KSHH-ja ndërmori një mision vëzhgimi në pikën e kontrollit të Kapshticës që ndan kufirin e Shqipërisë me atë të Greqisë.

Qëllimi i misionit ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia shqiptare dhe verifikimi i rasteve të shkeljeve të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga policia kufitare greke.

Bazuar në anketimet e bëra me emigrantë shqiptarë, KSHH-ja po bën verifikimet përkatëse.

Këto veprimtari janë zhvilluar në kuadër të projektit të KSHH-së "Monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve", mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit që ka filluar të zbatohet prej muajit janar 2004.

1.4 Misione mbështetëse të korrespondentëve lokalë të KSHH-së

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të korrespondentëve të KSHH-së në rrethe dhe rritjes së aksesit të tyre në fushën e vëzhgimit të të drejtave të njeriut, në kuadër të funksionimit të rrjetit të korrespondentëve KSHH vazhdoi nismën e marrë prej disa muajsh duke realizuar një mision mbështetës në Korçë.

Gjatë këtij misioni përfaqësues të KSHH-së morën takime me përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore, të policisë, gjykatës dhe prokurorisë dhe organet të tjera në nivel vendor.³

² Këto vëzhgime janë kryer në kuadër të projektit "Rrjeti i korrespondentëve në 7 rrethe të Shqipërisë", financuar nga SOROS.

³ Këto vëzhgime janë kryer në kuadër të projektit "Rrjeti i korrespondentëve në 7 rrethe të Shqipërisë", financuar nga SOROS.

2 VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE

2.1 Emisione në televizione lokale

Me qëllim informimin më të mirë të publikut në nivel vendor, përfaqësues të KSHH-së organizuan një emision në televizionin lokal në rrethin e Korçës. Nëpërmjet këtij programi publiku mësoi më shumë rreth gjëndjes dhe funksionimit të komisarariatit të policisë, të gjykatës në Rrethin e Korçës dhe respektimin e të drejtave të shtetasve nga këto institucione. Pjesë e këtij programi ishte njohja më e mirë e KSHH-së, misionit dhe rolit të tij në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtetasve.

2.2 Edukim i publikut nëpërmjet librit

Në datën *5 Maj 2004*, Komiteti Shqiptar i Helsinkit mori pjesë në panairin e librit të organizuar nga Këshilli i Europës, me rastin e 55 vjetorit të krijimit të tij. KSHH-ja prezantoi dhe shpërdau rreth 27 tituj publikimesh të tija në fushën e të drejtave të njeriut. Këto publikime ju ofruan një publiku të gjërë, siç ishin përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues nga përfaqësitë diplomatike, studentë, gjimnazistë si dhe qytetarë të ndryshëm të cilët ishin të interesuar për këto publikime.

Edhe më pare, KSHH-ja ka bashkëpunuar me organizata të të drejtave të njeriut vendase dhe të huaja në veprimtari të tilla duke i vlerësuar ato si ura komunikimi dhe informimi dhe sensibilizimi të publikut.

3.RAPORTE MBI RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Bazuar në misionet e vëzhgimeve të kryera në komisarariatet e policisë së rretheve ku vepron rrjeti i korrespondentëve KSHH-ja përgatiti dhe botoi një raport i cili paraqet përfundimet e dala nga vëzhgimet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e respektimit të të drejtave të shtetasve nga organet e rendit, administrata e komisariateve të policisë dhe e vendeve të paraburgimit.⁴

4. VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE DHE EDUKUESE NË DREJTIM TË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË MINORITEVE

Me qëllim informimin dhe sensibilizimin e shtetasve për të drejtat e minoriteteve dhe denoncimin e tyre, KSHH-ja në bashkëpunim me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (SOROS) publikuan fletëpalosjen “Të njohim dhe të mbrojmë të drejtat tona”. Në këtë fletëpalosje paraqiten në mënyrë të përmbledhur dhe me gjuhë të thjeshtë disa nga të drejtat dhe liritë themelore të pakicave kombëtare si dhe detyrimet ligjore që ka shteti shqiptar ndaj tyre. Gjithashtu, KSHH i bën thirrje popullsisë së minoriteteve që të denoncojnë pranë KSHH-së rastet e shkeljes të tyre, raste të diskriminimit nga administrata publike. Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Roli i shoqërisë civile në mbrojtjen dhe sensibilizimin e publikut për të drejtat e pakicave kombëtare” projekt që zbatohet nga KSHH-ja në bashkëpunim me Fondacionin e Shoqërisë së Hapur Civile, Tiranë.

⁴ Këtë raport mund ta gjeni të plotë në anglisht dhe në shqip në faqen tonë të internetit www.ahc.org.al

5. TRYEZA DHE KONFERENCA

Një nga format e veprimtarisë së KSHH-së lidhur më përmirësimin e praktikës së zbatimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të shtetasve janë dhe takimet e ekspertëve dhe tryezat e rrumbullakta për tematika të caktuara.

5.1 Tryeza e rrumbullakët “Shërbimi ligjor falas dhe ai i caktuar kryesisht. Çfarë mund të përmirësojmë?”

Nisur nga shqetësimet e ngritura në letrat dhe ankesat e shtetasve lidhur me shërbimin avokator, KSHH kreu një studim të legjislacionit dhe të praktikës së zbatimit të ligjit të avokatisë në përgjithësi, dhe asaj të mbrojtjes falas në veçanti.

Përfundimet e studimit dhe të anketimit të kryer u diskutuan në një tryezë të rrumbullakët me temë: “Shërbimi avokator falas dhe ai i caktuar kryesisht. Çfarë mund të përmirësojmë?” të organizuar në datën 27 Maj 2004 në ambientet e hotel Sheraton.

Studimi dhe vëzhgimi në praktikë i respektimit të të drejtave të personave që përfitojnë shërbim avokator falas dhe kryesisht identifikoi probleme të shumta, që çojnë në shkeljen e të drejtave të njeriut.

Për pjesëmarrësit interes paraqitën opinionet e personave të arrestuar dhe të dënuar të intervistuar, mendimet e vetë prokurorëve, gjyqtarëve dhe avokatëve si edhe rekomandimet e KSHH-së për përmirësimin e shërbimit ligjor falas dhe atij kryesisht.⁵

Në këtë tryezë të rrumbullakët morën pjesë përfaqësues të lartë të Ministrisë së Drejtësisë, të Gjykatave të shkallëve të ndryshme në Tiranë, përfaqësues të bordit drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Dhomës së Avokatisë Tiranë, të Prokurorisë, të policisë, Avokatit të Popullit, avokatë, përfaqësues të shoqërisë civile të huaj dhe të vëndit si dhe ekspertë të njohur në këtë fushë.


6. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-së NDAJ SHKELJEVE TË TË DREJTAVE TË DREJTAVE TË NJERIUT

Ndaj shkeljeve më flagrante të të drejtave të njeriut, karahas letrave dhe rekomandimeve drejtuar autoriteteve shtetërore, KSHH-ja ka reaguar publikisht. Gjatë muajit maj 2004, KSHH ka bërë tre deklarata publike lidhur me gjuhën e urrejtjes të deputetëve dhe politikanëve, me procesin zgjedhor dhe hapat e shpejta që duhen ndërmarrë në këtë drejtim si dhe për ushtrimin e dhunës në dhomat e paraburgimit të Laçit. Sipas një rendi kronologjik po ju paraqesim të plota deklaratat e KSHH-së gjatë muajit maj 2004.

7. SHTETASIT I DREJTOHEN KSHH-së

Gjatë periudhës Maj 2004 në adresë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit kanë ardhur **37 letra dhe ankesa**, kryesisht nga persona të dënuar të cilët vuajnë dënimin në burgjet e Shqipërisë. Pjesa më e madhe e ankesave kanë si objekt shkeljeje të drejtat e shtetasve gjatë procesit gjyqësor, realizmin e së drejtës të mbrojtjes, kjo edhe për arsye të njoftimit që KSHH-ja dërgoi në të gjitha burgjet në kuadër të studimit të ndërmarrë lidhur me këtë shërbim. Të shumta janë dhe ankesat për proceset e parregullta gjyqësore si dhe për vendime të padrejta. Më poshtë, po paraqesim në mënyrë grafike ankesat e trajtuara nga KSHH-ja.

⁵ Studimi i legjislacionit dhe raporti i dalë nga anketimi si dhe rekomandimet përkatëse do të botohen së shpejti në një publikim të veçantë.



8. KSHH DHE MEDIA

Të gjitha veprimtaritë e KSHH-së të zhvilluara gjatë muajit maj 2004 kanë gjetur pasqyrim në mediat e shkruara dhe ato elektronike. Deklaratat e KSHH-së janë botuar në median e shkruar dhe elektronike që KSHH ka monitoruar.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa intervista me drejtues të KSHH-së lidhur me probleme të ndryshme. Gjithashtu, konferencat dhe tryezat e rumbullakëta të zhvilluara nga KSHH-ja kanë gjetur një pasqyrim të plotë nga pjesa më e madhe e mediave elektronike dhe atyre të shkruar.

9. KSHH DHE BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATATAT VENDASE DHE ATO TË HUAJA

Edhe gjatë muajit maj KSHH-ja ka bashkëpunuar me organizata të të drejtave të njeriut, vendase dhe të huaja si Federata e Helsinkit, Komitetet e tjera të Helsinkit, Amnesty International, etj..

Në bashkëpunim të ngushtë me Amnesty International, KSHH-ja ndjek rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut kryesisht në rastet e keqtrajtimit të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar nga forcat e policisë si dhe rastet e ushtrimit të dhunës në kufij nga forcat policore të huaja kufitare. Bazuar në verifikimet e kryera, KSHH-ja ka reaguar publikisht si edhe i është drejtuar autoriteteve përkatëse.

Këtij qëllimi i shërbeu takimet e përfaqësuesve të KSHH-së me Znj. Melanie Anderson dhe Jan Jansen, përfaqësues të organizatës Amnesty International, takime që u zhvilluan më **31 Maj 2004**, në ambjentet e KSHH-së.

Gjatë takimeve, përfaqësuesit e Amnesty International dhe të KSHH-së diskutuan raste konkrete të keqtrajtimit nga forcat e policisë të qytetarëve gjatë shoqërimit, në momentin e ndalimit apo arrestimit si dhe raste të keqtrajtimit të shtetasve shqiptarë nga policia greke.

Në fund të takimit, u sigurua një bashkëpunim më i frytshëm për të ardhmen ndërmjet të dy organizatave.

10. PJËSËMARRJA E KSHH-së NË VEPRIMTARI TË NDRYSHME

Gjatë kësaj periudhë përfaqësues të KSHH-së dhe anëtarë të stafit të tij kanë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme të organizuar nga institucionet vendave dhe të huaja dhe organizatat ndërkombëtare dhe vendase që veprojnë në Shqipëri.

Aneks - DEKLARATA TË KSHH-SË

Tiranë, 3 maj 2004

Thirrje e Komitetit Shqiptar të Helsinkit Drejtuar të gjitha partive politike

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) me keqardhje konstaton se ende partitë politike nuk po ndërmarrin hapa konkretë për të diskutuar raportin e OSBE/ODIHR-it dhe rekomandimet përkatëse lidhur me zgjedhjet e vitit të kaluar.

Siç dihet, nga zgjedhjet e Tetorit të vitit 2003 kanë kaluar afërsisht 7 muaj. Ka mbi 2 muaj që është bërë i njohur raporti i OSBE/ODIHR-it. Nodhemi para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare e megjithatë, veç disa deklaratave që pjesërisht janë akuza të ndërsjellta partiake, nuk ka asnjë nismë që të tregojë se partitë politike po angazhohen seriozisht me përgatitjet që do të garantonin zgjedhje të lira, të ndershme dhe të pakontestuar.

Përvoja negative e zgjedhjeve të vitit të kaluar, pa mohuar arritjet, vërtetoi se vonesat në hartimin dhe miratimin e Kodit të ri Zgjedhor si dhe mungesa e vullnetit politik u shoqëruan me pasoja të dëmshme në të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. Do të ishte e pajustificuar dhe e pafalshme që të përsëritej e njëjta gjë kur dihet se ne jemi në provë, se zgjedhjet e ardhshme do të jenë një test i rëndësishëm drejt integritit të Shqipërisë në familjen e madhe Evropiane.

KSHH shpreh gjithashtu shqetësimin e tij se atmosfera në vend është e acaruar. Në këto kushte vështirësohet dialogu partiak në një kohë kur përmirësimet në legjislacionin zgjedhor kërkojnë përpjekje të përbashkëta dhe serioze, mirëkuptim, tolerancë dhe respektim të mendimit të kundërt.

KSHH përshëndet nismën e Presidentit si dhe çdo nismë tjetër që do t'i shërbente zbutjes së klimës politike në vend dhe që do të kontribuonte në zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

KSHH si një organizatë e pavarur dhe me përvojë në fushën e monitorimit të zgjedhjeve, ashtu si në të kaluarën, është i gatshëm të japë kontributin e tij modest në përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit zgjedhor.

KSHH vlerëson në mënyrë të veçantë si rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, edhe komentet e nivelit përgjithësues dhe cilësor të ODIHR-it dhe Komisionit të Veneceias lidhur me disa dispozita të Kodit Zgjedhor.

KSHH është gjithashtu i bindur se përvoja dhe kontributi i specialistëve dhe ekspertëve tanë në këtë fushë do të ishin gjithashtu të dobishme.

Me këtë rast, KSHH i bën edhe një herë thirrje Qeverisë që të rrisë angazhimin e saj për të përmbyshur detyrimet ligjore që ajo ka, lidhur me përgatitjet dhe zhvillimin normal të zgjedhjeve, sidomos në drejtim të saktësisimit dhe plotësisimit të regjistrave të gjendjes civile në bazë të të cilave do të hartohen listat e zgjedhësve.

2. Deklaratë për shtyp

Tiranë, më 8 maj 2004

Përdorimi i dhunës është i dënueshëm Të paraburgosurit të trajtohen në përputhje të ligjit

Ditën e premte, datë 7 maj 2004, rreth orës 22:00 persona të arrestuar dhe të dënuar në komisariatit e rrethit Laç u ngritën në revoltë dhe morën peng një gardian. Sipas pretendimit të tyre, kushtet në paraburgim janë të këqija dhe se ndaj tyre ka patur raste keqtrajtimi dhe se disa persona të dënuar nuk janë transferuar ende në burgje.

Duke marrë shkak nga kjo ngjarje si dhe duke vlerësuar gjendjen e vendeve të paraburgimit në Shqipëri, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH-ja) herë pas herë ka reaguar për shkelje të të drejtave të

personave të ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar. Megjithë reagimet e tij dhe të organizatave të tjera të drejtave të njeriut, vendase dhe të huaja, gjendja në vendet e paraburgimit mbetet problematike.

KSHH-ja me keqardhje vëren se procesi i transferimit të vendeve të paraburgimit nga varësia e Ministrisë së Rendit Publik në atë të Ministrisë së Drejtësisë është i ngadaltë dhe pjesërisht formal. Ky proces i filluar me kalimin e komisaritit të Vlorës tregoi se situata e të drejtave të personave të arrestuar nuk është përmirësuar. Është paradoksal fakti, që kalimi i këtij vendi paraburgimi është bërë jo i plotë, për aq kohë sa përgjegjësia e menaxhimit të këtij komisarati është pjesërisht në varësi të Ministrisë së Rendit Publik dhe asaj të Drejtësisë.

KSHH-ja vëren se ka disa vjet që flitet për hapjen e burgut të Lezhës dhe vënien në kapacitet të plotë në shfrytëzim të burgut të Peqinit. Sipas Z. Ramadan Hasanaj, Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve të Shqipërisë, seksioni i sigurisë së lartë me një kapacitet 400 vende pranë Burgut të Peqinit nuk funksionon ende. Burgu i Lezhës me një kapacitet 1 500 vende gjithashtu nuk është vënë në shfrytëzim. KSHH-ja është e mendimit se hapja e këtij burgu dhe shfrytëzimi i plotë i burgut të Peqinit do të zgjidhte problemin e mbipopullimit dhe do të përmirësonte respektimin e të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar.

KSHH-ja dënon aktet e revoltës kolektive dhe marrjen peng të personelit të vendit të paraburgimit, por në të njëjtën kohë, i bën thirrje organit të prokurorisë të hetojë me objektivitet dhe me precedencë këtë ngjarje dhe pretendimet për keqtrajtme të personave të arrestuar nga personeli i vendeve të paraburgimit si dhe për kushtet e këqija në këtë komisarati.

KSHH-ja i bën thirrje Qeverisë Shqiptare, dhe veçanërisht Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të kryejnë sa më shpejt procesin e transferimit të vendeve të paraburgimit, duke ndërmarrë hapa konkrete dhe të mbështetura financiarisht, dhe jo kalime formale të cilat e rëndojnë pozitën e personave të arrestuar dhe të dënuar.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit disa herë e ka ngritur këtë problem, por me keqardhje konstaton se në këtë drejtim vazhdojnë të dhunohen aktet ndërkombëtare, dispozitat kushtetuese, ligji 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim”.

KSHH-ja i bën thirrje organit të Prokurorisë së Përgjithshme të marrë masa për të forcuar kontrollin e këtij organi për respektimin e të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar dhe për trajtimin e tyre në vendet e paraburgimit dhe në burgje.

KSHH-ja i bën thirrje prokurorive të rretheve ku ka vende paraburgimi dhe burgje të forcojnë kontrollin e tyre rreth procedurës së ekzekutimit të vendimeve penale dhe respektimin e afatave të transferimit të personave të dënuar nga vendet e paraburgimit në burgje.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i bën thirrje Ministrisë së Drejtësisë të rishikojnë rregulloren e trajtimit të personave në vendet e paraburgimit me qëllim trajtimin human dhe njerëzor të tyre.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i bën thirrje Ministrisë së Rendit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të marrë masa administrative ndaj personave që kanë në administrim vendet e paraburgimit dhe burgje kur çënojnë ligjin dhe rregulloret e brendshme në institucione.

3 Letër e Hapur

Tiranë, më 17 Maj 2004

Letër e hapur

Kjo është hera e dytë që organizatat tona ju drejtohen Juve Zoti Kryetar i Kuvendit dhe juve zotërinj deputetë, kryetarë të grupeve parlamentare për një problem që vazhdon të jetë shqetësues. Është çështja e gjuhës së urrejtjes, e fyerjeve nga më të rëndomtat, e akuzave nga më monstruozet që përdoren në seancat parlamentare. Në këto kushte nuk mund të flitet jo më për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, por as për etikën më elementare.

Të nderuar deputetë:

Pluralizmi demokratik që gjen shprehjen edhe në zhvillimin e seancave parlamentare nënkupton luftën luajale dhe konstruktive, shpalosjen e alternativave që synojnë thellimin e proceseve demokratike dhe integrimin e vendit tonë në familjen Evropiane. Në jemi të ndërgjegjshëm se debati parlamentar në disa raste mund të shoqërohet edhe me ndonjë nervozizëm apo mungesë vetpërmabajtjeje, por jo deri në atë masë sa ta ndiejnë vehten të fyer dhe ata që ju dëgjojnë, sa të mos flasin mirë për ju edhe fëmijët ndaj të cilëve ju, dhe

ne të gjithë kemi detyrime të shumta në radhë të parë për edukimin e tyre. Brezi i ri pret gjithashtu më tepër nga Ju, përfaqësuesit e popullit. Atij duhet t'i rritet besimi për një të ardhme më të mire demokratike.

Në një vend demokratik është i njohur si roli i pozitës, edhe ai i opozitës, por të dyja këto forca konsiderohen kundërshtarë politikë dhe jo grupime armiqësore. Akuzat e ndërsjella që ju përdorni janë aq të mëdha përsa i përket rrezikshmërisë shoqërore dhe aq të shumta në shtrirjen e tyre, saqë njerëzit e thjeshtë që ndjekin transmetimin e seancave parlamentare, e kanë të vështirë të dallojnë dhe të besojnë kush është i ndershmi dhe kush i korruptuari, kush është i pafajshmi dhe kush është kriminel. Me keqardhje ju vëmë në dijeni se në takimet tona me shtetas të shtresave të ndryshme, pavarësisht nga bindjet e tyre, simpatitë përkatësitë e tyre partiake, kanë shprehur dëshpërimin dhe indignatën e tyre për gjuhën që përdoret në Kuvend, për sjelljet e pahijshme të mjaft deputetëve.

Me të drejtë Kuvendi cilësohet si tempull i demokracisë dhe i parlamentarizmit. Kështu do të dëshironim të ishte edhe në praktikë, ndërsa ato që shikojmë dhe dëgjojmë na bindin se jemi ende larg këtij objektivit. Detyrat e përfaqësuesit të popullit siç dihet, është që me qëndrimet dhe sjelljet e tij, kudo, por në mënyrë të veçantë në organin më të lartë legjislativ të ndikojnë pozitivisht në edukimin e njerëzve, me respekt për rregullin, ligjin dhe institucionet. E vërteta, edhe pse e hidhur, është se kjo nuk po ndodh.

Para disa kohësh u diskutua për nevojën e miratimit të një ligji lidhur me etikën parlamentare. Ne e përshëndetëm këtë nismë dhe do të dëshironim që miratimi i tij të ndikonte në zhvillimin e ekuilibruar dhe të kulturuar të seancave parlamentare, megjithëse nuk besojmë që shkak i kësaj gjendjeje të jetë mungesa e ligjit.

Ne jemi dëshmitarë se në zgjedhjet e fundit numri i pjesëmarrësve në votime ishte relativisht i vogël. Ky është një tregues që kërkon reflektim në radhë të parë nga klasa jonë politike. E vërteta është se ka lëkundje në besimin e njerëzve ndaj Jush. Këtë situatë po e rëndon edhe më tepër atmosfera e acaruar parlamentare, gjuha e turpshme që përdoret, si dhe mospërfillja e opinionit të gjerë shoqëror që nuk pajtohet me këtë gjendje.

Në deklaratat dhe konferenca shtypi flitet shpesh për nevojën e rritjes së imazhit të Shqipërisë. Por seancat tuaja parlamentare tejet të politizuara, si dhe mungesa e vullnetit politik për të dialoguar nuk i shërbejnë rritjes së këtij imazhi, përkundrazi e çenojnë atë.

Në përfundim do të dëshironim që përmbajtja e kësaj letre të konsiderohej si një shqetësim i shoqërisë civile që është direkt e interesuar për një proces aktiv dhe të kulturuar parlamentar, për dialog midis forcave politike, gjë që do të kontribuonte në stabilitetin e vendit, zgjidhjen e drejtë dhe të shpejtë të problemeve që na preokupojnë, si dhe përballimin e sfidave drejt integritimit Evropian.

Populli vëzhgon. Elektorati mban shënim dhe reagon me votën e tij. Ju jeni në provë. Do të ishte mirë që shqetësimi i organizatave tona dhe i shumë të tjerëve, të vlerësohej me seriozitetin e duhur.

ORGANIZATAT JO-FITIMPRURËSE HARTUES E TË KËSAJ LETRE TË HAPUR:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
GRUPI SHQIPTAR I TË DREJTAVE TË NJERIUT
QENDRA SHQIPTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SHOQATA PËR KULTURË DEMOKRATIKE
SHOQATA E KONSTITUCIONALISTËVE SHQIPTARË
QENDRA PËR STUDIMET PARLAMENTARE

Përgatiti për Internet: Etilda SALIU
Juriste/As.projektsh

Për më shumë informacion mund të na kontaktoni në adresën:
Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr: Gjin Bue Shpata, Pall. 5/1, Ap.4, Tiranë,
Kutia postare Nr. 1752
Tel: 04 233671 & 04 229002
Fax: 04 233 671
E-mail: office@ahc.org.al